

*Përgjegjës në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave 360°, në Drejtorinë e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës në Sektorin e Përpunimit të të Dhënave 360°, në Drejtorinë e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- a) Drejtimin, organizimin dhe koordinimin e veprimtarisë së sektorit që ka në varësi dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij;
- b) Planifikimin e përgatitjen e projekteve për realizimin e kapjes (mbledhjes) së informacionit gjeohapësinor nëpërmjet kamera 360 gradë;
- c) Organizimin e proceseve të punës që lidhen me analizimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet kamera 360 gradë;
- d) Planifikimin dhe kontrollin e punimeve që lidhen me publikimin e informacionit të përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë kamera 360 gradë, për autoritetet publike dhe përdoruesve;
- e) Monitorimin e cilësisë së proceseve të mbledhjes së të dhënave me anë të teknologjisë kamera 360 gradë, për të përcaktuar nëse janë të nevojshme ndryshime procedurale ose të pajisjeve si dhe përgatit dhe raporton/prezanton, raporte teknike për cilësinë e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve të përfuara me anë të teknologjisë kamera 360 gradë etj;
- f) Hartimin dhe propozimin e draft/akteve-nënligjore/manualeve, në bashkëpunim me institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, për mënyrën e përdorimit të informacionit të përfuar nga monitorimi i territorit me teknologji kamera 360 gradë bazuar nga përvoja ndërkombëtare dhe situata brenda vendit;
- g) Krijimin e raporteve periodike për aktivitetet e kryera nga sektori dhe i raporton tek prori direkt dhe Drejtori i Përgjithshëm;

- h) Kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të sektorit që lidhen me mbledhjen, analizimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet përdorimit të teknologjisë 360 gradë, dhe siguron përmbushjen e detyrave të tij;
- i) Korrigjimin e çdo shmangieje të konsiderueshme që mund të rezultojë mes objektivave dhe rezultatit faktik dhe merr masa për rregullimin e tyre;
- j) Zhvillimin e punës të ushtrohet referuar në rregulla, procedura dhe politika të mirëpërcaktuara duke bërë dhe propozimet për ndryshime, kur e shikon të nevojshme;
- k) Shpërndarjen e punës midis specialisteve të sektorit për përmbushjen e funksioneve të këtij sektori në kohë dhe me cilësi;
- l) Menaxhimin e bazës së të dhënave dhe çdo informacion që lidhet me mbledhjen, analizimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet përdorimit të teknologjisë 360 gradë, të krijuar apo marrë në dorëzim, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- m) Kontribuon në realizimin e planit vjetor të institucionit dhe arritjen e objektivave në përputhje me fushën e veprimit të këtij sektori;
- n) Përgatitjen e materialeve informuese për drejtorin e drejtorisë lidhur me mbarëvajtjen dhe problematikat e punës së këtij sektori në realizimin e objektivave të tij;
- o) Përcaktimin e objektivave të qarta për secilin anëtar të stafit të këtij sektori në mënyrë që puna e sektorit të vlerësohet objektivisht dhe ia paraqet për miratim drejtorit të drejtorisë;
- p) Dhënien e kontributit në procesin e vendimmarrjes të nivelit të mesëm drejtues, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara, konsultimeve dhe analizave sipas fushës së veprimit që lidhen me mbledhjen, analizimin dhe publikimin e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet përdorimit të teknologjisë 360 gradë;
- q) Bashkërendimin e veprimeve dhe nismave të autoriteteve publike në fushën e informacionit gjeohapësinor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë 360 gradë, sipas udhëzimeve të drejtorit të drejtorisë;
- r) Përfaqësimin e institucionit në takime pune dhe konferenca lidhur me fushën e veprimtarisë që mbulon sektori, sipas propozimit të drejtorit të drejtorisë dhe miratim të drejtorit të përgjithshëm.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

1. Të këtë mbaruar studimet e larta e të zotërojë një diplomë të nivelit “Master Shkencor”, diplomuar për Gjeodezi/Topogjeodezi, Gjeoinformatikë, Arkitekturë.
2. Të këtë përvojë 3 vjeçare në pozicione në nivel ekzekutiv;
3. Të këtë njohuri shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave dhe programeve lidhur me fushën e specialitetit. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve;
4. Të zotërojë aftësi për të shkëmbyer ide dhe mendime teknike dhe për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi;

5. Të njohë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe funksionimin ligjor të ASIG si dhe legjislacionin e BE-së që lidhet me gjeoinformacionin;
6. Të ketë njohuri që lidhen me proceset që shoqërojnë përpunimin e imazheve të mbledhura me kamera 360 gradë, në krijimin e hartave tematike të ndryshme për mbështetje në krijimin e infrastrukturës së gjeoinformacionit në Shqipëri.
7. Të ketë eksperiencë përdorimi për programet kompiuterike bazë dhe ato të avancuara si ArcGIS Desktop, ArcGIS Online, QGIS, AutoCAD.
8. Të njohë mirë gjuhën angleze, njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË ( III-1 )**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 29.01.2024, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit të dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.